

VENDIM
Nr. 277, datë 1.4.2015

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOZHSHËM, NGA MINISTRIA E
MBROJTJES TE MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE, TË DISA OBJEKTEVE DHE TË SIPËRFAQES
TRUALL FUNKSIONAL, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME
3 035.6 M², BREDA TERRITORIT TË PRONËS ME NUMËR RENDOR 90, ME
EMËRTIM “REPARTI USHTARAK NR. 4400 (ISH-SHTABI I KML-SË)”, ME
VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim të përkohshëm, për një periudhë 30-vjeçare, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të disa objekteve dhe të sipërfaqes truall funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 3 035.6 (tre mijë e tridhjetë e pesë pikë gjashtë) m², brenda territorit të pronës me numër rendor 90, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4400 (Ish-Shtabi i KML-së)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, sipas planvendosjes dhe planimetrive, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për t’i përdorur për sistemimin e administratës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në nivel qendror, dhe AKU-së, Tiranë, me ambiente pune, në funksion të veprimtarisë së këtij institucioni, sipas ndarjes që do të përcaktohet nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

2. Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave i ndalohet të ndryshojë destinacionin e objekteve dhe të sipërfaqes së truallit funksional, të pronës me numër rendor 90, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4400 (ish-Shtabi i KML-së)”, me vend-ndodhje në Brar, Tiranë, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.


3. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLANVENDOSJA E PRONES Nr.90 REP. USHT. 4400 (ISH SHTABI I K. M. L.) TIRANE






SHKALLA 1 :500


PUNOI

Topog. Selman . Lleshi

PLANIMETRIA E KATIT PERDHE /eripunu




Kati perdhe sip.611 m2




PLANIMETRIA E KATIT TE PARE

/e ripunuar/




E PARE SHK 1:100

Kati i pare sip. 611 m²



(e ripunuar)



YTE shk 1:100

Kati i dyte sip.611 m2

